



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT
Sektori pronësoro-juridik

INr. 464-67445

Në mbështetje të neneve 13,14,58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 të datës:20.02.2008, neneve 17, 40, 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit INr.110-623 të datës: 26.09.2008, dhe neneve 37, 84 të Ligjit për Procedurën Administrative Nr.02/L-28 të datës:22.07.2005, me datë 07.12.2016 merr:

VENDIM

I. VENDOSSET (dislokohet) përkohësisht në parcelën komunale P-71409080-00007-0 zona kadastrale Grackë e Vjetër (përball tregut të kafshëve), tregu i mobiljeve dhe orendive të ndryshme që aktualisht zhvillojnë veprimtarinë e tyre në pjesën e parcelës kadastrale P-71409044-01371-0 ZK Lipjan.

II. Obligohen të gjithë personat që merren me veprimtarinë siq ceket në pikën 1 që pas vendosjes së njoftimit publik në hyrje të parcelës, të vendosen në parcelën kadastrale 00007 për të zhvilluar veprimtarinë e tyre.

III. Me nga një kopje të këtij Vendimi njoftohet Kompania NTP "Kastrioti" Carraleve-Shtime dhe Drejtorati i Inspektionit.

Arsyetim

Pjesa e parcelës kadastrale P-71409044-01371-0 ZK Lipjan e cila në bazë të Certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme është pronë e stadiumit të qytetit "Sami Kelmendi", prej shumë vitesh shfrytëzohet nga personat që mirren me tregti për ushtrimin e veprimtarisë tregtare të mobiljeve dhe orendive të ndryshme.

Në parcelën e cekur më lartë kanë filluar punimet për rindërtimin dhe zgjerimin e stadiumit të qytetit "Sami Kelmendi".Zgjerimi i stadiumit do të përfshin edhe pjesën që aktualisht shfrytëzohet për treg të mobijeve dhe orendive të ndryshme.

Andaj në mënyrë që punimet të vazhdojnë dhe të realizohet projekti i rregullimit të stadiumit dhe njëkohësisht personeve që mirren me veprimtarinë e tyre të iu mundësohet vazhdimi i punës së tyre, është e domosdoshme që tregu i mobiljeve dhe orendive të ndryshme përkohësisht të vendoset (dislokohet) në parcelën komunale P-71409080-00007-0 zona kadastrale Grackë e Vjetër (përball tregut të kafshëve), siq përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi nga dita e miratimit të tij.

Personat zyrtar:

Lumnije Ejupi
Jeton Zymeri



Kryetari i Komunës
Imri Ahmeti